



Kombëtarja Shqiptare ka zbritur për 7 vende në renditjen e FIFA-s per muajin shtator. Dy humbjet e pak diteve me pare kane detyruar kuqezinjte te nisin tatepjeten duke I dhene fund rekordeve te njepasnjeshme. Ne muajin e kaluar mbanim vendin e 38 ndersa tani menjehere kuqezinjte kane zbritur ne vendin e 45 me 652 pike te grumbulluara. Endrra Brazil ka perfunduar dhe tani Shqiperia, mban vendin e peste ne grupin E. Kane mbetur edhe dy ndeshje nga edicioni, te cilat do te luhen me muajin tetor ndaj Zvicres dhe Qipros. Ne rast rezultatesh pozitive mund te kemi shprese per te rekuperuar serish terren ne renditjen boterore qe na sherben per te ardhmen.